

## **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Sherbime**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

#### **OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“AVOLXHIM ELEKTROMOTORRESH, RIPARIM POMPASH DHE TRANSFORMATORESH”**

#### **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**-Sherbim per riparimin dhe mirembajtjen e pompave 50511000-0**

FONDI LIMIT: Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 49.522.300,00 (Dyzet e nente milion e peseqind e njezet e dy mije e treqind) Lekë pa TVSH.

**Vlera e fondit Limit ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 533.300,66 (peseqind e tridhjet e tre mije e treqind presje gjashtedhjetë e gjashtë) Euro.**

**Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 17.08.2026 është 92.86 euro.**

**Argumentimi: Perlllogaritja e vleres se fondit limit eshte bere referuar Nenit 35 te ligjit nr.162/2020, si dhe nenit nr.13 dhe nenit nr.76 te VKM 285 date 19.05.2021, të ndyshuar**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor SHRUKD sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:**

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër me një Operator Ekonomik, kur janë përcaktuar të gjitha kushtet, arsyet e përzgjedhjes janë si më poshtë::

Kryerja e shërbimeve objekt prokurimi (avolxhimi i elektromotorëve, riparimi i pompave, transformatorëve dhe pajisjeve të tjera) nga operatorë të ndryshëm ekonomikë nuk do të ishte

zgjidhja më e favorshme për Autoritetin Kontraktor, pasi do të shoqërohej me kosto administrative shtesë dhe vonesa në realizimin e shërbimeve, për shkak të zhvillimit të procedurave të minikonkurrimit për çdo kontratë të veçantë. Ndryshimi i OE në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa OE ku të gjitha kushtet nuk janë të përcaktuara do të shkaktonte kosto shtesë, pasiguri dhe konfuzion për OE të suksesshëm, gjë që do të shoqërohej me rritjen e afateve të kryerjes së shërbimit. Lidhja e MK me një OE të vetëm, do të shoqërohej me mirëorganizimin e këtij të fundit për kryerjen e shërbimit në kohë.

Për më tepër, ndryshimi i operatorit ekonomik nga një kontratë në tjetrën do të krijonte vështirësi në koordinimin teknik, në ndjekjen e historikut të ndërhyrjeve dhe në organizimin e realizimit të shërbimeve. Ndërsa lidhja e marrëveshjes kuadër me një operator ekonomik të vetëm mundëson planifikim më të mirë të burimeve njerëzore, mjeteve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme, duke garantuar realizimin e shërbimeve në kohë dhe sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Marrëveshja kuadër me disa operatorë ekonomikë, kur jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, nuk përbën në vetvete kontratë dhe nuk garanton lidhjen e kontratave të veçanta. Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor nuk disponon mekanizma detyrues që sigurojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të suksesshëm në minikonkurse. Kjo mund të sjellë vonesa ose dështime në realizimin e shërbimeve, duke ndikuar negativisht në funksionimin normal të aktivitetit të SHRUKD sh.a.

Me qëllim garantimin e realizimit të shërbimeve brenda afateve të përcaktuara, sigurimin e vazhdimësisë së funksionimit të sistemeve dhe administrimin sa më efikas të kontratës, Autoriteti Kontraktor vlerëson se lidhja e Marrëveshjes Kuadër me një operator ekonomik të vetëm përbën alternativën më të përshtatshme. Kjo garanton kryerjen e shërbimeve sipas kushteve të përcaktuara, brenda afateve të kërkuara dhe siguron stabilitet në menaxhimin e kontratës dhe në përmbushjen e nevojave të Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:**

***Sqarim:***Argumentimi për mosndarjen e procedurës në lote.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2 ku prashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Në përputhje me nenin 42 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, autoriteti kontraktor ka detyrimin të vlerësojë mundësinë e ndarjes së kontratës në lote kur procedura është mbi kufirin e lartë monetar. Pas analizës së objektit të prokurimit “Avolxhim elektromotorresh, riparim pompash dhe transformatorësh”, është konstatuar se ndarja në lote nuk është e përshtatshme për arsyet e mëposhtme:

Tërësia funksionale: Shërbimet e përfshira (avolxhimi i elektromotorëve, riparimi i pompave, riparimi i transformatorëve etj.) janë të ndërlidhura dhe përbëjnë një tërësi funksionale, e cila garanton mirëmbajtjen dhe rikthimin në gjendje pune të pajisjeve objekt prokurimi. Ndarja e procedurës në lote do të fragmentonte procesin e mirëmbajtjes, do të vështirësonte koordinimin ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe mund të shkaktonte vonesa në realizimin e shërbimeve.

Efikasiteti ekonomik: Procedura e unifikuar siguron ekonomi shkalle, ulje të kostove administrative dhe shmangje të menaxhimit të shumë kontratave. Kjo është në përputhje me parimin e përdorimit sa më efikas të fondeve publike.

Koordinimi teknik: Shërbimet objekt prokurimi kërkojnë koordinim teknik të vazhdueshëm, diagnostikim, riparim dhe rikthim në funksion të pajisjeve brenda afateve të nevojshme të Autoritetit Kontraktor. Ndarja e procedurës në lote do të krijonte vështirësi në koordinimin ndërmjet operatorëve ekonomikë, do të rriste kohën e realizimit të shërbimeve dhe do të rrezikonte ndërprerjen ose vonesën e funksionimit normal të pajisjeve.

Garancia dhe përgjegjësia: Një kontraktor i vetëm mund të ofrojë garanci të plotë për cilësinë e shërbimit. Në rast të ndarjes në lote, përgjegjësia do të shpërndahej dhe do të vështirësohej kontrolli i cilësisë.

Interesi SHRUKD: Realizimi në kohë i shërbimeve të avolxhimit të elektromotorëve, riparimit të pompave, transformatorëve dhe pajisjeve të tjera objekt prokurimi është i domosdoshëm për garantimin e funksionimit të pandërprerë të sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Një kontratë e unifikuar siguron koordinim më efikas, redukton rrezikun e vonësve dhe garanton realizimin e shërbimeve sipas afateve dhe kërkesave të Autoritetit Kontraktor..

Ndarja në lote nuk do të sillte përfitime reale për konkurrencën, pasi tregu ofron operatorë ekonomikë që mbulojnë të gjithë gamën e shërbimeve të kërkuara. Përkundrazi, ndarja do të krijonte barrë disproporcionale për administrimin e procedurës.

Për sa më lart AK gjykon dhe argumenton se nuk ka vend për ndarjen në lotë të procedurës objekt prokurimi.

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit**

#### **2.2 Kapaciteti ekonomiko-financiar**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, pika 2 c) nën 55 pika 4, si dhe nën 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

**2.2.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nën 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a). për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nën 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikimet vetiake, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit. Si me meposhte:

- SSH/UNI/DIN/EN ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

- SSH/UNI/DIN/EN ISO 45001 “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

- SSH/UNI/DIN/EN ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Certifikatat duhet të jene lëshuar nga nje organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Standarti SSH/UNI/DIN/EN ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm pasi ndikon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, duke qenë se ky standart

fokusohet në cilësinë e procesit të riparimit të automjeteve, rrjedhimisht siguron AK që ofertuesi do të përmbushë/realizojë shërbimet objekt prokurimi, sipas pritshmërive/specifikimeve teknike të kërkuara. Implementimi i këtij standarti ndihmon në optimizimin e burimeve dhe përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve, duke ulur kostot dhe kohën e riparimit.

Standarti SSH/UNI/DIN/EN 14001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” – është vendosur si kriter duke marrë në konsideratë faktin që ky Standarti është një sistem sistematik dhe i orientuar drejt procesit të menaxhimit të cilësisë për të kontrolluar impaktet e rëndësishme të aktiviteteve të biznesit në mjedis, dhe në rastin konkret duke qenë se objekt i prokurimit janë shërbimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, procese gjatë të cilave përdoren produkte që mund të jenë të dëmshme për mjedisin, si vajrat dhe kimikatet. Paisja me këtë standart është e rëndësishme sepse siguron që ofertuesi do të zbatojë politika të qëndrueshme mjedisore, duke zvogëluar ndotjen dhe ndikimin e dëmshëm në mjedis.

Standarti SSH/UNI/DIN/EN ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” është vendosur si kriter me qëllim që AK të sigurohet që ofertuesi kryen shërbimin në përputhje me standartet e kërkuara sa i takon shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe me qëllim parandalimin/shmangien e çfarëdo rreziku, pasi shërbimet që do të kryhen përfshijnë një sërë rreziqesh për aksidente në punë, si dëmtime nga makineritë që do të përdoren për kryerjen e shërbimeve, djegie nga substanca të nxehta, lëndime nga kontaktet me kimikate toksike apo ndotëse, madje edhe ndotje akustike.

**2.3.3** Operatori ekonomik të disponojë makineritë e nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

1. Torro
2. Freze
3. Piale
4. Furre Pjekje
5. Bobinatrice
6. Tegolatrice
7. Izolatrice Fondotorno
8. Kompjuter Kolaudimi
9. Strapatrice
10. Pajisje për testim me tension të induktuar 2(UN) me frekuencë 100Hz



11. Filter vakumi per pastrimin kimik te vajit
12. Pajisje per matjen e tensioni te cpimit te vajit deri ne 80 kV

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesin:

Dokumenta qe vertetojne se këto pajisje i ka aktualisht në pronësi ose me qera, ose me huapërdorje ( faturave tatimore te blerjes/ dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

*Shenim :Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi.

Makineritë dhe pajisjet kërkohen për arsyt si më poshtë:

1. Torno – përdoret për përpunimin mekanik të boshteve, kushinetave, foleve dhe pjesëve cilindrike të elektromotorëve, pompave dhe transformatorëve, duke rikthyer dimensionet dhe tolerancat teknike të kërkuara.
2. Frezë – përdoret për përpunimin e sipërfaqeve, foleve, kanaleve dhe elementëve mekanikë që kërkojnë përpunim me saktësi gjatë riparimit të pajisjeve.
3. Piale – shërben për rrafshimin dhe përpunimin e sipërfaqeve metalike, duke garantuar montimin korrekt të komponentëve mekanikë.
4. Furrë pjekjeje (tharje) – përdoret për tharjen e mbështjelljeve elektrike pas impregnimit me llak izolues, proces i domosdoshëm për arritjen e parametrave të izolimit elektrik dhe jetëgjatësisë së avolxhimit.
5. Bobinatrice – përdoret për realizimin e mbështjelljeve (bobinave) të reja të elektromotorëve dhe transformatorëve sipas parametrave teknikë të projektimit.
6. Tegolatrice – përdoret për formësimin dhe sistemimin e bobinave gjatë procesit të avolxhimit, duke garantuar vendosjen korrekte të tyre në kanalet e statorit ose bërthamës.



7. Izolatrice/Fondotorno – përdoret për vendosjen dhe përpunimin e materialeve izoluese në mbështjellje, duke garantuar nivelin e kërkuar të izolimit elektrik dhe mbrojtjen nga defektet ndërfazore.
8. Kompjuter kolaudimi – përdoret për diagnostikimin, monitorimin dhe regjistrimin e parametrave elektrikë dhe mekanikë gjatë testimit përfundimtar të pajisjeve të riparuar.
9. Strapatrice – përdoret për shtrëngimin dhe fiksimin e mbështjelljeve ose komponentëve gjatë proceseve të montimit dhe riparimit, duke garantuar qëndrueshmërinë mekanike të tyre.
10. Pajisje për testim me tension të induktuar 2(UN) me frekuencë 100 Hz – është pajisje e specializuar për kryerjen e provave dielektrike të transformatorëve pas riparimit, duke verifikuar integritetin e izolimit ndërmjet mbështjelljeve dhe aftësinë e pajisjes për të punuar në parametrat nominalë.
11. Filter vakumi për pastrimin kimik të vajit – përdoret për filtrimin, dehidratimin dhe degazimin e vajit izolues të transformatorëve, duke rikthyer vetitë fiziko-kimike dhe dielektrike të tij sipas kërkesave teknike.
12. Pajisje për matjen e tensionit të çpimit të vajit deri në 80 kV – përdoret për verifikimin e cilësisë dielektrike të vajit izolues pas filtrimit, duke siguruar që vaji plotëson parametrat teknikë për funksionimin e sigurt të transformatorit.

Disponimi i këtyre makinerive dhe pajisjeve garanton që operatori ekonomik ka kapacitetin teknik për të kryer të gjitha fazat e procesit të riparimit, nga diagnostikimi dhe përpunimi mekanik deri te avolxhimi, trajtimi i izolimit, riparimi i transformatorëve dhe testimet përfundimtare. Për rrjedhojë, ky kriter lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës, është proporcional me natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve që do të realizohen dhe synon të sigurojë një ekzekutim cilësor, të sigurt dhe në përputhje me standardet teknike përkatëse.

**2.3.4** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

- Te pakten 1 (nje) Inxhinier Elektrik

- Te pakten 1(nje) punetor, te pajisur me kartela personale te sigurimit teknik grupi IV, te leshurara nga organe kopetente te akredituara sipas ligjit 8734 date 01.02.2001 i ndryshuar.

Në lidhje me punonjësin në pikën (a), duhet të paraqitet:

- diploma e arsimit të lartë

- kontratë pune me afat vlefshmerie brenda afatit të zbatimit të shërbimeve për këtë objekt prokurimi.

-Listepagesa e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore per periudhen Prill – Qershor 2026 te konfirmuara nga administrata tatimore

-CV

Në lidhje me punonjës in në pikën (b), duhet të paraqitet:

- kartelat perkatese te sigurimit teknik
- Listepagesa e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore per periudhen Prill – Qershor 2026 te konfirmuara nga administrata tatimore

*Shenim :Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë staf in, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë të paktën 1 (një) Inxhinier Elektrik dhe të paktën 1 (një) punonjës të pajisur me Kartelë Personale të Sigurimit Teknik Grupi IV, lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve objekt të kontratës, të cilat përfshijnë avolxhimin e elektromotorëve, riparimin e pompave dhe transformatorëve, si dhe testimin dhe vënien në punë të tyre.

#### 1. Inxhinieri Elektrik

Prania e të paktën një Inxhinieri Elektrik është e domosdoshme për të garantuar drejtimin teknik të proceseve të diagnostikimit, avolxhimit, riparimit, montimit dhe testimit të pajisjeve elektrike. Inxhinieri Elektrik është përgjegjës për:

- analizimin dhe identifikimin e defekteve elektrike;
- përcaktimin e metodologjisë së riparimit sipas karakteristikave teknike të pajisjes;
- mbikëqyrjen e procesit të avolxhimit dhe respektimin e parametrave elektrikë të projektimit;
- verifikimin e rezultateve të provave elektrike dhe funksionale pas riparimit;

- garantimin që pajisjet e riparuar plotësojnë parametrat teknikë dhe kushtet e sigurisë për rikthimin në shërbim.

Duke qenë se objekti i kontratës përfshin pajisje elektrike me tensione dhe fuqi të ndryshme, prania e një specialisti me formim inxhinierik është e nevojshme për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e shërbimit.

## 2. Punonjës i pajisur me Kartelë Personale të Sigurimit Teknik – Grupi IV

Kërkesa për të paktën një punonjës të pajisur me Kartelë Personale të Sigurimit Teknik Grupi IV, të lëshuar nga organet kompetente sipas Ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike", i ndryshuar, është e domosdoshme pasi shërbimet objekt kontrate përfshijnë ndërhyrje në pajisje dhe instalime elektrike, kryerjen e matjeve, testeve dhe provave elektrike, si dhe punime që paraqesin rrezik për sigurinë në punë.

Ky punonjës garanton që ndërhyrjet në pajisjet elektrike kryhen nga personel i kualifikuar, i trajnuar dhe i autorizuar për të punuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e sigurimit teknik, duke minimizuar rrezikun e aksidenteve dhe dëmtimit të pajisjeve.

Për rrjedhojë, kërkesa për këtë personel është e lidhur ngushtë me objektin e kontratës, proporcionale me natyrën e shërbimeve dhe synon të garantojë që kontrata të realizohet në përputhje me standardet profesionale, kërkesat teknike dhe rregullat e sigurisë në punë. Kjo kërkesë nuk kufizon konkurrencën, por siguron që operatori ekonomik disponon kapacitetet minimale profesionale të nevojshme për realizimin e kontratës.

## 2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

**2.4.1** Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon ambient me sipërfaqe jo më të vogël se 200 m<sup>2</sup>, ku ushtron veprimtarinë për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesin:

- Dokumentacionin që vërteton pronesinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

**Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë një ambient me sipërfaqe jo më të vogël se 200 m<sup>2</sup> është vendosur në funksion të realizimit cilësor dhe të sigurt të shërbimeve objekt prokurimi, që përfshijnë avolxhimin e elektromotorëve, riparimin e pompave dhe transformatorëve.

Realizimi i këtyre shërbimeve kërkon vendosjen dhe funksionimin e makinerive dhe pajisjeve teknologjike me përmasa të mëdha, si makineri për avolxhim, furra për tharjen e mbështjelljeve, presa hidraulike, pajisje ngritëse (vinça ose vinça urë), stenda testimi, pajisje për impregnimin e mbështjelljeve dhe makineri të tjera të specializuara. Për shkak të dimensioneve të tyre dhe kërkesave për sigurinë teknike, këto pajisje kërkojnë një ambient pune të mjaftueshëm, i cili mundëson instalimin, operimin dhe mirëmbajtjen e tyre në kushte normale pune.

Gjithashtu, gjatë procesit të riparimit është e nevojshme të krijohen hapësira të veçanta për çmontimin, magazinimin e përkohshëm të pjesëve, kryerjen e riparimeve mekanike dhe elektrike, montimin, testimin përfundimtar dhe lëvizjen e sigurt të elektromotorëve, pompave dhe transformatorëve, të cilët në shumë raste kanë peshë dhe përmasa të konsiderueshme.

Për këto arsye, sipërfaqja minimale prej 200 m<sup>2</sup> është vlerësuar si një kërkesë proporcionale dhe e domosdoshme për garantimin e realizimit të kontratës në përputhje me standardet teknike, rregullat e sigurisë në punë dhe cilësinë e kërkuar të shërbimit. Kjo kërkesë synon të sigurojë që operatori ekonomik disponon kapacitetin infrastrukturor të nevojshëm për përmbushjen e kontratës dhe nuk vendos kufizime të pajustificuara ndaj konkurrencës.

Operatori ekonomik duhet të provojë disponimin e ambientit nëpërmjet dokumentacionit që vërteton pronësinë, qiramarrjen, huapërdorjen ose çdo të drejtë tjetër të ligjshme përdorimi, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit janë të hartuara nga Grupi i Punës, në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Shënim: Në çdo rast kur në specifikimet teknike mund të jetë e përdorur si referencë emri i ndonjë marke apo emri të veçante, patente, vizatim ose tip ose origjine ose prodhim specifik, përfshihet dhe fjala “ose ekuivalent” i saj.

## **SASIA E PARASHIKUAR DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Specifikimi i Materialeve:**

**Sasia e parashikuar per avolxhimin e elektromotorreve:**

**Tabela 1**

| <b>Nr</b> | <b>Emertimi</b>                              | <b>Sasia</b> |
|-----------|----------------------------------------------|--------------|
| 1         | 500 kW (electromotor centrifugal horizontal) | 1            |
| 2         | 440 kW (elektromotor centrifugal horizontal) | 2            |
| 3         | 350 kW (elektromotor zhytes uje I pijshem)   | 2            |
| 4         | 315 kW(elektromotor centrifugal horizontal)  | 2            |
| 5         | 200 kW(elektromotor centrifugal horizontal)  | 1            |
| 6         | 110 kW (elektromotor zhytes uje I pijshem)   | 2            |
| 7         | 75 kW(elektromotor zhytes kanalizime)        | 2            |
| 8         | 55 kW(elektromotor zhytes kanalizime)        | 1            |
| 9         | 30 kW(elektromotor zhytes kanalizime)        | 1            |
| 10        | 18.5 kW(elektromotor zhytes kanalizime)      | 1            |
| 11        | 300 kW(elektromotor centrifugal horizontal)  | 1            |
| 12        | 250 kW(elektromotor centrifugal horizontal)  | 1            |
| 13        | 125 kW(elektromotor centrifugal horizontal)  | 1            |
| 14        | 37 kW(elektromotor zhytes)                   | 1            |
| 15        | 22 kW(elektromotor centrifugal horizontal)   | 1            |
| 16        | 17.5 kW(elektromotor zhytes)                 | 1            |
| 17        | 15 kW(elektromotor zhytes)                   | 1            |
| 18        | 11 kW(elektromotor vertikal siperfaqesor)    | 1            |

|    |                                      |   |
|----|--------------------------------------|---|
| 19 | 9 kW(elektromotor zhytes)            | 1 |
| 20 | 6 kW(elektromotor zhytes kanalizime) | 1 |
| 21 | 5.5 kW(elektromotor zhytes )         | 1 |
| 22 | 5 kW(elektromotor zhytes )           | 1 |
| 23 | 4 kW(elektromotor zhytes )           | 1 |

Sasia e perashikuar per riparimin e pompave:

Tabela 2

| Nr | Emertimi                                | Sasia |
|----|-----------------------------------------|-------|
| 1  | 440 KW (Pompe horizontale centrifugale) | 2     |
| 2  | 350 Kw (Pompe zhytese horizontale)      | 1     |
| 3  | 315 KW(Pompe horizontale centrifugale)  | 2     |
| 4  | 300 KW(Pompe horizontale centrifugale)  | 2     |
| 5  | 250 KW(Pompe horizontale centrifugale)  | 2     |
| 6  | 110 KW (Pompe zhytese)                  | 1     |
| 7  | 75 kW(Pompe zhytese kanalizime)         | 4     |
| 8  | 30 KW(Pompe zhytese kanalizime)         | 2     |
| 9  | 18.5 kW(Pompe vertikale siperfaqesore)  | 4     |
| 10 | 500 KW (Pompe horizontale centrifugale) | 2     |
| 11 | 125 kW(Pompe horizontale centrifugale ) | 1     |
| 12 | 55 KW(Pompe zhytese kanalizime)         | 1     |
| 13 | 22 KW(Pompe horizontale centrifugale)   | 4     |
| 14 | 18.5 kW(Pompe zhytese kanalizime)       | 2     |

Sasia e perashikuar per riparimin e transformatoreve:

Tabela 3

| Nr | Emertimi                         | Sasia |
|----|----------------------------------|-------|
| 1  | Transformator 250 kvA 6/0.4 kV   | 1     |
| 2  | Transformator 100 kvA 6/0.4 kV   | 1     |
| 3  | Transformator 2000 kvA 20/0.4 kV | 1     |
| 4  | Transformator 250 kva 20/0.4 kv  | 1     |
| 5  | Transformator 5600 kva 35/20 kv  | 1     |
| 6  | Transformator 100 kva 10/0.4 kv  | 1     |
| 7  | Transformator 50 kva 10/0.4 kv   | 1     |
| 8  | Transformator 250 kva 10/0.4 kv  | 1     |
| 9  | Transformator 400 kva 20/6 kv    | 1     |
| 10 | Transformator 1250 kva 20/0.4 kv | 1     |

### SPECIFIKIMET TEKNIKE PER AVOLXHIM ELEKTROMOTORRESH

|     |                                                                          |          |                                              |  |  |
|-----|--------------------------------------------------------------------------|----------|----------------------------------------------|--|--|
| I.1 | Emertimi                                                                 | $S_n$    | 500 Kw (elektromotor horizontal centrifugal) |  |  |
| I.2 | Tensioni nominal I punes                                                 | $U (TM)$ | 6 kV                                         |  |  |
| II  | PUNIME ÇMONTIMI, TESTET PARAPRAKE DHE RAPORTI PERFUNDIMTAR I DEMENTIMEVE | Njesia   |                                              |  |  |



|       |                                                                           |         |   |  |  |
|-------|---------------------------------------------------------------------------|---------|---|--|--|
| II.1  | Matjet paraprake dhe vleresimi                                            | grup    | 1 |  |  |
| II.2  | Hapja e kapakeve                                                          | komplet | 1 |  |  |
| II.3  | Nxjerrja e rotorit                                                        | cope    | 1 |  |  |
| II.4  | Raporti perfundimtar i demtimeve                                          | grup    | 1 |  |  |
| III   | PUNIME RIPARUESE                                                          |         |   |  |  |
| III.1 | Riparimi, pastrimi i peshtjellave te T.M                                  | cope    | 1 |  |  |
| III.2 | Riparimi, pastrimi i nuklit                                               | cope    | 1 |  |  |
| III.3 | Riparimi, pastrimi i kapakut                                              | cope    | 2 |  |  |
| III.4 | Pergatitja e izolimit prej kartoni ndermjet peshtjellave T.M per nje faze | cope    | 3 |  |  |
| III.5 | Pergatitja e nje peshtjelle te re te T.M                                  | cope    | 3 |  |  |
| IV    | PUNIME MONTIMI                                                            |         |   |  |  |
| IV.1  | Montimi i izolimit prej kartoni ndermjet peshtjellave T.M per nje faze    | cope    | 3 |  |  |
| IV.2  | Montimi i nje peshtjele te TM                                             | cope    | 3 |  |  |
| IV.3  | Montimi i zgjedhes                                                        | komplet | 1 |  |  |
| IV.4  | Tharja e peshtjellave T.M                                                 | komplet | 1 |  |  |
| IV.5  | Montimi i morseterise                                                     | cope    | 1 |  |  |
| V     | TESTET PERFUNDIMTARE NE UZINEN RIPARUESE                                  |         |   |  |  |
| V.1   | Testet e izolacionit                                                      | grup    | 1 |  |  |
| V.2   | Prova pa ngarkese                                                         | grup    | 1 |  |  |
| VI    | PUNIME TE TJERA                                                           |         |   |  |  |

|       |                                                    |         |   |  |  |
|-------|----------------------------------------------------|---------|---|--|--|
| VI.1  | Ngarkimi ne kamjon dhe transporti                  | komplet | 1 |  |  |
| VI.2  | Zevendesimi i guarnicioneve te ndryshem            | cope    | 2 |  |  |
| VI.3  | Zevendesimi i nje prizhioneri te izolatorit te T.M | cope    | 6 |  |  |
| VI.4  | Zevendesimi i kushinetave                          | cope    | 2 |  |  |
| VI.5  | Nje bulon çeliku                                   | cope    | 6 |  |  |
| VI.6  | Nje bulon bronzi                                   | cope    | 0 |  |  |
| VI.7  | Zevendesimi i nje fleksibeli te T.M                | cope    | 3 |  |  |
| VI.8  | Saldimi i pjeseve prej çeliku                      | cm      | 3 |  |  |
| VI.9  | Lyerja e elektromotorit                            | grup    | 1 |  |  |
| VI.10 | Montimi dhe venia ne pune ne impiantin e vendosur  | grup    | 1 |  |  |
|       |                                                    |         |   |  |  |

|      |                                                                          |          |                                         |  |  |
|------|--------------------------------------------------------------------------|----------|-----------------------------------------|--|--|
| I.1  | Emertimi                                                                 | $S_n$    | 440 Kw (e.motor horizontal centrifugal) |  |  |
| I.2  | Tensioni nominal I punes                                                 | $U (TM)$ | 6 kV                                    |  |  |
| II   | PUNIME ÇMONTIMI, TESTET PARAPRAKE DHE RAPORTI PERFUNDIMTAR I DEMENTIMEVE | Njesia   |                                         |  |  |
| II.1 | Matjet paraprake dhe vleresimi                                           | grup     | 1                                       |  |  |
| II.2 | Hapja e kapakeve                                                         | komplet  | 2                                       |  |  |
| II.3 | Nxjerrja e rotorit                                                       | cope     | 1                                       |  |  |
| II.4 | Raporti perfundimtar i demtimeve                                         | grup     | 1                                       |  |  |
| III  | PUNIME RIPARUESE                                                         |          |                                         |  |  |

|       |                                                                           |         |   |  |  |
|-------|---------------------------------------------------------------------------|---------|---|--|--|
| III.1 | Riparimi, pastrimi i peshtjellave te T.M                                  | cope    | 1 |  |  |
| III.2 | Riparimi, pastrimi i nuklit                                               | cope    | 1 |  |  |
| III.3 | Riparimi, pastrimi i kapakut                                              | cope    | 2 |  |  |
| III.4 | Pergatitja e izolimit prej kartoni ndermjet peshtjellave T.M per nje faze | cope    | 3 |  |  |
| III.5 | Pergatitja e nje peshtjelle te re te T.M                                  | cope    | 3 |  |  |
| IV    | <b>PUNIME MONTIMI</b>                                                     |         |   |  |  |
| IV.1  | Montimi i izolimit prej kartoni ndermjet peshtjellave T.M per nje faze    | cope    | 3 |  |  |
| IV.2  | Montimi i nje peshtjele te TM                                             | cope    | 3 |  |  |
| IV.3  | Montimi i zgjedhes                                                        | komplet | 1 |  |  |
| IV.4  | Tharja e peshtjellave T.M                                                 | komplet | 1 |  |  |
| IV.5  | Montimi i morseterise                                                     | cope    | 1 |  |  |
| V     | <b>TESTET PERFUNDIMTARE NE UZINEN RIPARUESE</b>                           |         |   |  |  |
| V.1   | Testet e izolacionit                                                      | grup    | 1 |  |  |
| V.2   | Prova pa ngarkese                                                         | grup    | 1 |  |  |
| VI    | <b>PUNIME TE TJERA</b>                                                    |         |   |  |  |
| VI.1  | Ngarkimi ne kamjon dhe transporti                                         | komplet | 1 |  |  |
| VI.2  | Zevendesimi i guarnicioneve te ndryshem                                   | cope    | 2 |  |  |
| VI.3  | Zevendesimi i nje prizhioneri te izolatorit te T.M                        | cope    | 6 |  |  |
| VI.4  | Zevendesimi i kushinetave                                                 | cope    | 2 |  |  |

|       |                                                   |      |   |  |  |
|-------|---------------------------------------------------|------|---|--|--|
| VI.5  | Nje bulon çeliku                                  | cope | 6 |  |  |
| VI.6  | Nje bulon bronzi                                  | cope | 0 |  |  |
| VI.7  | Zevendesimi i nje fleksibeli te T.M               | cope | 3 |  |  |
| VI.8  | Saldimi i pjeseve prej çeliku                     | cm   | 3 |  |  |
| VI.9  | Lyerja e elektromotorit                           | grup | 1 |  |  |
| VI.10 | Montimi dhe venia ne pune ne impiantin e vendosur | grup | 1 |  |  |
|       |                                                   |      |   |  |  |

|       |                                                                          |          |                                       |  |  |
|-------|--------------------------------------------------------------------------|----------|---------------------------------------|--|--|
| I.1   | Emertimi                                                                 | $S_n$    | 350 Kw (e.motor zhytes uje I pijshem) |  |  |
| I.2   | Tensioni nominal I punes                                                 | $U (TU)$ | 0.4 kV                                |  |  |
| II    | PUNIME ÇMONTIMI, TESTET PARAPRAKE DHE RAPORTI PERFUNDIMTAR I DEMENTIMEVE | Njesia   |                                       |  |  |
| II.1  | Matjet paraprake dhe vleresimi                                           | grup     | 1                                     |  |  |
| II.2  | Hapja e kapakeve                                                         | komplet  | 2                                     |  |  |
| II.3  | Nxjerrja e rotorit                                                       | cope     | 1                                     |  |  |
| II.4  | Raporti perfundimtar i demtimeve                                         | grup     | 1                                     |  |  |
| III   | PUNIME RIPARUESE                                                         |          |                                       |  |  |
| III.1 | Riparimi, pastrimi i peshtjellave te T.U                                 | cope     | 1                                     |  |  |
| III.2 | Riparimi, pastrimi i nuklit                                              | cope     | 1                                     |  |  |
| III.3 | Riparimi, pastrimi i kapakut                                             | cope     | 2                                     |  |  |

|       |                                                                           |         |   |  |  |
|-------|---------------------------------------------------------------------------|---------|---|--|--|
| III.4 | Pergatitja e izolimit prej kartoni ndermjet peshtjellave T.U per nje faze | cope    | 3 |  |  |
| III.5 | Pergatitja e nje peshtjelle te re te T.U                                  | cope    | 3 |  |  |
| IV    | <b>PUNIME MONTIMI</b>                                                     |         |   |  |  |
| IV.1  | Montimi i izolimit prej kartoni ndermjet peshtjellave T.U per nje faze    | cope    | 3 |  |  |
| IV.2  | Montimi i nje peshtjele te TU                                             | cope    | 3 |  |  |
| IV.3  | Montimi i zgjedhes                                                        | komplet | 1 |  |  |
| IV.4  | Tharja e peshtjellave T.U                                                 | komplet | 1 |  |  |
| IV.5  | Montimi i morseterise                                                     | cope    | 1 |  |  |
| V     | <b>TESTET PERFUNDIMTARE NE UZINEN RIPARUESE</b>                           |         |   |  |  |
| V.1   | Testet e izolacionit                                                      | grup    | 1 |  |  |
| V.2   | Prova pa ngarkese                                                         | grup    | 1 |  |  |
| VI    | <b>PUNIME TE TJERA</b>                                                    |         |   |  |  |
| VI.1  | Ngarkimi ne kamjon dhe transporti                                         | komplet | 1 |  |  |
| VI.2  | Zevendesimi i guarnicioneve te ndryshem                                   | cope    | 2 |  |  |
| VI.3  | Zevendesimi i nje prizhioneri te izolatorit te T.U                        | cope    | 6 |  |  |
| VI.4  | Zevendesimi i kushinetave                                                 | cope    | 2 |  |  |
| VI.5  | Nje bulon çeliku                                                          | cope    | 6 |  |  |
| VI.6  | Nje bulon bronzi                                                          | cope    | 0 |  |  |
| VI.7  | Zevendesimi i nje fleksibeli te T.U                                       | cope    | 3 |  |  |
| VI.8  | Saldimi i pjeseve prej çeliku                                             | cm      | 3 |  |  |

|       |                                                   |      |   |  |  |
|-------|---------------------------------------------------|------|---|--|--|
| VI.9  | Lyerja e elektromotorit                           | grup | 1 |  |  |
| VI.10 | Montimi dhe venia ne pune ne impiantin e vendosur | grup | 1 |  |  |
|       |                                                   |      |   |  |  |

|       |                                                                           |          |                                        |  |  |
|-------|---------------------------------------------------------------------------|----------|----------------------------------------|--|--|
| I.1   | Emertimi                                                                  | $S_n$    | 315 kW(e.motor horizontal centrifugal) |  |  |
| I.2   | Tensioni nominal I punes                                                  | $U (TU)$ | 0.4kV                                  |  |  |
| II    | PUNIME ÇMONTIMI, TESTET PARAPRAKE DHE RAPORTI PERFUNDIMTAR I DEMTIMEVE    | Njesia   |                                        |  |  |
| II.1  | Matjet paraprake dhe vleresimi                                            | grup     | 1                                      |  |  |
| II.2  | Hapja e kapakeve                                                          | komplet  | 2                                      |  |  |
| II.3  | Nxjerrja e rotorit                                                        | cope     | 1                                      |  |  |
| II.4  | Raporti perfundimtar i demtimeve                                          | grup     | 1                                      |  |  |
| III   | PUNIME RIPARUESE                                                          |          |                                        |  |  |
| III.1 | Riparimi, pastrimi i peshtjellave te T.U                                  | cope     | 1                                      |  |  |
| III.2 | Riparimi, pastrimi i nuklit                                               | cope     | 1                                      |  |  |
| III.3 | Riparimi, pastrimi i kapakut                                              | cope     | 2                                      |  |  |
| III.4 | Pergatitja e izolimit prej kartoni ndermjet peshtjellave T.M per nje faze | cope     | 3                                      |  |  |
| III.5 | Pergatitja e nje peshtjelle te re te T.U                                  | cope     | 3                                      |  |  |
| IV    | PUNIME MONTIMI                                                            |          |                                        |  |  |

|       |                                                                        |         |   |  |  |
|-------|------------------------------------------------------------------------|---------|---|--|--|
| IV.1  | Montimi i izolimit prej kartoni ndermjet peshtjellave T.M per nje faze | cope    | 3 |  |  |
| IV.2  | Montimi i nje peshtjele te TU                                          | cope    | 3 |  |  |
| IV.3  | Montimi i zgjedhes                                                     | komplet | 1 |  |  |
| IV.4  | Tharja e peshtjellave T.U                                              | komplet | 1 |  |  |
| IV.5  | Montimi i morseterise                                                  | cope    | 1 |  |  |
